



GREEN Solution

Tirana, Albania. Tel: +355 69 83 90 970

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

**EMËRTIMI I PROJEKTIT:
IMPIANT PRODHIMI ASFALTOBETONI.**

**VENDODHJA:
QARKU DURRËS, BASHKIA SHIJAK, NJËSIA ADMINISTRATIVE XHAFZOTAJ,
FSHATI XHAFZOTAJ, PRANË KRYQËZIMIT 4 RRUGËT.**

Sipas shtojces 1 te Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar, Veprimtaritë e katranit dhe të bitumit, pika 7.3.c, "Veprimtaritë që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi".

Leje Mjedisit Tipi B.

**Kërkues:
Subjekti "A.L-ASFALT" SHPK
NIPT: K81511508A**

Ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u hartua nga Studio:
"GREEN Solution"

Laert Shehu

Administratör



Punoi raportin:

Ing. Laert Shehu

Ing. Vanina Latifi

Janar, 2019

TABELA:

STRUKTURA E RENDITJES DHE INFORMACIONIT QË PËRMBAN KY RAPORT I VNM

Hyrje

1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR.....	8
2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.....	9
3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.	13
4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.....	25
5. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.....	29
6. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.....	29
7. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS.....	30
8. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.....	30
9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.....	30
10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).....	32

HYRJE


Ky raport i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, hartohet me kërkesë të subjektit “A.L-ASFALT” SHPK, NIPT: K81511508A, me seli në Durres, Xhafzotaj, Komuna Xhafzotaj, Prane Kryqezimit 4 Rrugët dhe me administrator Z. Astrit Varaku dhe Z. Luan Mema. Ky subjekt, zhvillon aktivitetin e prodhimit të asfaltobetonit.

Objekti i vleresimit të këtij raporti janë ndikimet në mjedis të këtij aktiviteti. Aktiviteti i prodhimit të asfaltobetonit, sipas shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, klasifikohet në piken 7.3.c, “Veprimtaritë që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi”. Leje Mjedisit Tipi B. Objekti ndodhet pranë kryqezimit 4 rrugët, Fshati Xhafzotaj, Njesia Administrative Xhafzotaj, Bashkia Shijak, Qarku Durres. Rreth 600m në vijë ajrore, larg qendrave të banuara dhe rreth 1.7km në vijë ajrore larg lumit Erzen.



Ky raport i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, parashikon ndikimet në mjedis gjatë funksionimit të këtij impianti, nga shkarkimet në ajër të oxhakut të furres së ngrohjes së bitumit. Ndikimi më i madh dhe më i rëndësishëm është ai i shkaktuar nga oxhaku i furres së ngrohjes së bitumit, si pjesë e procesit të prodhimit të asfaltit. Ky aktivitet, zhvillohet në një shesh të krijuar për këtë qëllim, me një sipërfaqe rreth 4200m². Kapaciteti maksimal i prodhimit të impiantit është rreth 70-80 Ton/ore.

Subjekti që aplikon për leje mjedisore ka aktivitet ekzistues dhe kërkon që të pajiset me lejet përkatëse.


Ortofoto e vendodhjes së impiantit



IMPIANT PROD HIM ASFALTOBETONI
QARKU DURRËS, BASHKIA SHIJAK, NJËSIA ADMINISTRATIVE XHAFZOTAJ, FSHATI XHAFZOTAJ, PRANË KRYQËZIMIT 4 RRUGËT



Harta topografike e rajonit. Nomenklatura e Hartes ne shkalle 1:2500 (K-34-88-(242-A)



Koordinatat e objektit ne sistemin: Gaus-Krüge		
Nr.	Koordinatat Lindje X	Koordinatat Veri Y
1	4377355.08	4580961.68
2	4377341.10	4581005.75
3	4377256.24	4580982.14
4	4377268.30	4580936.93

Foto te aktivitetit





Foto te impiantit te prodhimit te asfaltobetoni





Kaldaja me lende djegese gas





Mjetet e renda te transportit



1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR

Përshkrimi qëllimit dhe objektivave të VNM

Ky Raport i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor për VNM dhe ka për qëllim që të parashikojë, identifikojë, vlerësojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin në mjedis të projektit të propozuar.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II të ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011;
- b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I të ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011;

Objektivat afatshkurter të VNM janë:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore të projektit të propozuar;
- Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrë të duhur dhe me efikasitet;
- Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit.
- Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të Disponueshme të teknologjisë së propozuar për tu aplikuar.
- Identifikon masat e duhura për zvogelimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit të propozuar;
- Mundeson informimin e vendim-marrësve, duke gjykuar në miratimin ose jo të projektit dhe kushteve që duhet të vendosen në aktin e miratimit.

Objektivat afatgjate të VNM janë:

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimitet e pakthyeshme të mjedisit;
- Ndikon në mbrojtjen e burimeve natyrore, peisazhet e natyrës dhe komponentet perberes të ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale-ekonomike të projektit
- Ndihmon në realizimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.

Përshkrim i përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin

Legjislacioni mjedisor është hartuar për të mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe demtimin e komponenteve të veçante dhe të rendesishme të mjedisit nga faktore të ndryshme, njerezore dhe natyrore.

Nder ligjet me kryesore në lidhje me këtë projekt, mund të përmendim:

- Ligji Nr. 10431 datë 09.06. 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".
- Ligji Nr. 10440 datë 07.07. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis".
- Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit".
- Ligji Nr. 10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".
- Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", i ndryshuar.
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit".
- Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 "Për menaxhimin e zhurmave".

- Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura". I ndryshuar me:-Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008.
- Vendim i KM Nr. 313, dt. 09.05.2012 "Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis".
- Vendim i KM Nr. 13, date 04.01.2013 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis".
- Vendim i KM Nr. 247, datë 30.4.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendim-marrjen mjedisore".
- Vendim i KM Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisëve ujore pritëse"
- Vendim i KM Nr. 538 dt.26.05.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera"
- Vendim i KM Nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL.
- Vendim i KM Nr. 676, datë 20.12.2002 "Për shpalljen e zonave te mbrojtura monument natyror".
- Vendim Nr. 417, date 25.06.2014 "Per miratimin e tarifave te lejeve te mjedisit"
- Udhëzim Nr. 8, dt.27.11.2007 "Per nivelet kufi te zhurmave".

Shenim:

Bazuar ne Ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", ky aktivitet, perfshihet ne listen e aktiviteteve qe duhet te pajiset me leje mjedisore te tipit A, B ose C. (Konkretisht pika 7.3.c. "Veprimtaritë që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi". Te gjitha instalimet Leje e tipit B.)

2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.

Aktiviteti ne vleresim eshte nje Impiant prodhimi asfaltobetoni, i ndodhur prane Kryqezimit 4 Rruget, Fshati Xhafzotaj, Njesia Administrative Xhafzotaj, Shijak, Durres. Relievi i vendit te instalimit eshte i sheshte. Bimesia e rajonit karakterizohet kryesisht nga brezi i shkurreve mesdhetare. Nderkohe perreth kantierit, verehen toka bujqesore te banoreve te zones te cilet dikur kane patur si burim kryesor te ardhurash aktivitetin bujqesor. Siperfaqja ku zhvillohet aktiviteti, nuk karakterizohet nga bimesia, eshte shesh i lire nga bimesia dhe nuk demtohet siperfaqe e gjelber. Ky aktivitet nuk demton as burimet ujore te rajonit.


Persa i perkete bimesise se rajonit te Durresit eshte e llojit barishtore dhe shkurre mesdhetare, tipike e zonave te mesdheut dhe klimes se rajonit, te përfaqësuara nga dafina, shqopa dhe nga shkurret te tjera në formën e kacubeve te veçanta. Pranë bregut te detit shtrihet një brez gjelbërimi me pisha te zhvilluara mire. Zona karakterizohet nga prania e një bimësie natyrore me moshe 80 vjeçare që dominohet kryesisht nga pisha e bute dhe e egër me moshe 19-24 vjeçare. Gjate bregdetit gjendet një baze pyjore natyre prej dushku dhe shelgu me moshe 60-80 vjeçare, i alternuar me pyll artificial prej pishash e plepash me moshe 20 vjeçare. Konditat klimatike te zonës lejojnë te zhvillohet një bimësi e shumëllojshme që nga pishat, plepi, frasheri i zi, morina, palma dhe dafina, deri në bimët e tjera dekorative si: frasheri gjethengushtë, vërria, eukalpti, shelgu lotues, etj. Te ruajtura në


forme natyrale shumica e drurëve te lartpërmendur gjenden në territorin e ish “Bllokut” që përben një zone me karakterin e një parku natyror te këndshëm.

Në zonat me te larta te rrethit (p.sh. zona e Ishmit) rriten shkurre që i rrezojnë gjethet e tyre gjate stines se dimrit si: shkuza, murrizi, driza, etj. Në Xhafzotaj, Sukth, Gjipale, Spital etj, rriten edhe bime te ulëta si: mullaga, hithra, lulekuqa, tatulla, kopra e egër, ndërsa gjethe delli, lulebasami, hithra, grami, rrodhja, netulla, bar pate rriten kryesisht në zonën e Shijakut, Maminasit, Katundi te Ri dhe Ishmit.

Përveç bimësisë pyjore që zë vend te rëndësishëm në bimësinë e rrethit, po kaq rendësi kane edhe kulturat buqesore te përfaqësuar nga : gruri, misri, fasulja, ulliri, lule dielli, te cilat përhapjen me te madhe e kane në zonën e Shijakut, Maminasit, Spitalles, Sukthi. Pothuajse në te gjithë rrethin kultivohen perime si: speci, domatja, kastravec, bizelja, etj. dhe agrumet (portokalli, limoni).

Bimesia e zones ne te cilen zhvillohet aktiviteti





Biodiversiteti dhe habitatet (te pergjithshme)

Biodiversiteti

Shqipëria vlerësohet për një larmi të madhe biologjike dhe peizazhore. Origjina të kësaj llojshmërie, është e lidhur me: pozicioni gjeografik, faktorët gjeologjikë, pedologjikë, hidrologjikë, relievi dhe klima. Larmia e madhe e ekosistemeve dhe habitateve (ekosistemeve detare, bregdetare, laguna e vende të lagëta, delta lumenjsh, duna ranore, liqene, lumenj, shkurreta mesdhetare, pyje gjethegjërë, halorë dhe të përzjerë, livadhe dhe kullota subalpine e alpine, ekosisteme të maleve të lartë), ofron një larmi të pasur llojesh bimore dhe shtazore duke përfaqësuar rreth 30% të florës Europiane. Ne percaktimin ligjor kemi kete percaktim: “Biodiversitet (shumllojshmeria biologjik) ose larmi biologjike” është tërësia e organizmave të gjallë të të gjitha llojeve, duke përfshirë, ndër të tjera, ekosistemet tokësore, detare dhe ekosistemet e tjera ujore, si dhe komplekset ekologjike, ku ato bëjnë pjesë. Vizioni ynë për biodiversitetin është: të sigurohet zhvillim normal i flores dhe faunes ne vendjetesat e tyre, që keto peizazhe jo vetem te zbukurojne natyren por dhe të kontribuojë në rritjen në begatinë e vendit e mirëqenjen e popullit. Me më shumë se 3200 lloje të bimëve vaskulare dhe 756 specie vertebrorë dhe me rreth 30% të të gjithë florës europiane që zhvillohet në Shqipëri, me të drejtë mund ndjeme krenari për natyrën tonë. Por, ndërsa koncepti i biodiversitetit ka percaktim globale, ruajtja është thjesht një aktivitet lokal. Sa takon ruajtjes te gjithë duhet te ndehemi fajtor per humbjet ne biodiversitet. Shqipëria si një vend që synon të anëtarësohet në BE ka përgjegjësinë për të ndërmarrë veprime konkrete për të mbrojtur Biodiversitetin e saj, duke qenë se humbja e këtij thesari me të gjithë ekosistemet, krijon efekte negative në ekonomi duke rrezikuar në një farë mënyre atë. Për të ndaluar humbjen e biodiversitetin në Shqipëri, duhet të ketë një sipërmarrje të përbashkët “Biodiversiteti është ekzistenca jonë, është ekzistenca juaj është

me rëndësi përfshirja e komunitetit, në mënyrë që të ruhet kjo pasuri që në fund na bën të ndihemi kaq shumë krenarë." Përpjekjet për të mbrojtur tokat natyrore dhe ujërat tona duhet të jenë fokusi i interesit dhe veprimtarisë së të gjithëve dhe vlerësimi i statusit të ruajtjes së llojeve të veçanta është çelësi për të kuptuar gjendjen e përgjithshme të florës dhe faunës dhe vendosjen e prioriteteve për ruajtjen", Humbja e biodiversitetit si problem global, përbën aktualisht një ndër problemet më të mëdha në bote. Ekspertet japin alarmin duke konkluduar: se nëse do të vazhdohet me këtë trend, humbja e biodiversitetit do të ketë pasoja fatale për njerëzimin. Vlerësimet e fundit shkencore parashikojnë se, me ritmet e sotme të shpyllëzimeve, brenda 25-30 viteve të ardhshëm do të zhduken deri në 10 % të llojeve të njohura në planet. Pasojat e kësaj humbje do të reflektohet edhe në ekonomine botërore dhe në zhvillimet shoqërore në përgjithësi, duke pasur parasysh faktin se afro 40 % e ekonomisë botërore dhe 80 % e nevojave të njeriut plotësohen nga resurset biologjike. Ruajtja e biodiversitetit është e rëndësishme dhe e domosdoshme për shume arsye, por me këtë rast do të përmendim vetëm disa prej tyre: Ruajtja e biodiversitetit është detyrim i yni moral që t'iu lemë pasardhësve një mjedis po aq të pasur sa kemi trashëguar nga paraardhësit tanë, Çdo qenie e gjallë ka të drejtë të jetojë, ashtu si dhe vetë njeriu; qeniet e gjalla që kanë jetuar dhe evoluar në mijëra milionë vjet mund të zhduken shumë shpejt, por nuk mund të krijohen përsëri, Mjedisin ndotet në tokë, ujë dhe ajër. Ky është një problem i madh i kohës sonë. Kështu përgjegjësit kryesor të ndotjes së ujërave të detit janë shkarkimet urbane, industriale, bujqësore të zonave më të zhvilluara, si edhe shkarkimet e naftës në zonat ku ajo nxirret. Edhe zonat e bregdeteve dhe ishujt rrezikohen nga ngrohja e klimës: shkrirja e një pjese të akullnajave çon në rritjen e nivelit të detit. Ndotja e ajrit dëmton jetën e njeriut, dëmton sytë, rrugët e frymëmarrjes. Sot në shumë vende ka agjenci që matin shkallën e ndotjes së ajrit dhe kur kjo është e lartë marrin masa si mbyllja e fabrikave, ndalojnë qarkullimin e makinave etj. Disa qytete të Shqipërisë, sidomos Tirana dhe Elbasani janë shumë të ndotur. Era e rëndë, thithja e ajrit të ndotur janë disa nga problemet e përditshme me të cilat përballen qytetet, ku trafiku i automjeteve, shkarkimet industriale dhe ngrohja e banesave janë të përqëndruara në zona të ngushta: kush banon në qytet e ndjen menjëherë problemin e ndotjes së mjedisit. Mbetjet urbane përmbajnë edhe produkte kimike që zbresin në thellësi dhe ndotin burimet e nëndheshme ujore. Në qytete, ndodhen gjithashtu edhe kantierët e ndërtimit, që shpesh derdhin nëpër lumenj sasi të mëdha materiali ndërtim. Zhvillimi i turizmit ka ndikime direkte në biodiversitet. Tashme vendi ynë është kthyer në një destinacion të njohur i orientuar tek ekoturizimi. Për fatkeq hapësira bregdetare ka qenë pre e shkatërrimeve që kanë rrjedhur nga përdorimi turistik i këtij rajoni. Pasojat më të mëdha të këtyre shkatërrimeve kanë të bëjnë me mbingarkesat ndërtimore të natyrës dhe të peizazhit. Të gjitha këto probleme konfliktuale që lindin midis turizmit dhe biodiversitetit në zonën bregdetare është shumë e rëndësishme ti parandalojmë në zonën malore dhe në peizazhet pyjore ekzistuese.

Gjëndja e disa specieveve aromatiko – mjekësore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukje

Nëpërmjet një sistemi monitorimi do të arrihet vlerësimi i gjëndjes së disa specieveve aromatiko-mjekësore të cilat janë në rrezik zhdukje si dhe përshkrimi i gjëndjes së Sherbelës në rajonin qendror të vendit tone, do të na japin të dhëna të plota, për bimët aromatiko-mjekësore. Me ane të këtij studimi synohet; Se pari, të identifikohen faktorët kryesorë sociale, ekonomike, dhe politike që kanë çuar drejt pakesimit. Së dyti, duke përdorur një analizë social-ekonomike, duke vlerësuar rëndësinë sociale dhe ekonomike për mbledhësit e këtyre prodhimeve. Se treti, të ofrojmë rekomandime për mbareshtimin në menyrë të

qëndrueshme dhe për të rritur të ardhurat e popullatës. Menazhimi dhe zhvillimi i aktivitetit të prodhimit të specieve aromatiko-mjeksore mundet të jetë një alternativë për rritjen e nivelit të të ardhurave plotësuese në zonat rurale , të tilla si;

- Kapaciteti i kufizuar i aftesive prodhuese
- Frangmentimi i theksuar i tokës në mesatarisht 3-4 ngastra për ferme
- Vështirësi të shumta financiare për sigurimin e mjeteve të nevojshme të prodhimit
- Mundësi të pakta për sigurimin e kredive
- Mungesa e një shërbimi ekstensionit.

Informacion rreth bimesise dhe zonave te mbrojtura te rajonit

Në Shqipëri, zonat e mbrojtura sidomos 10 vjeçarit e fundit, janë kthyer në një objekt të rëndësishëm pune të disa institucioneve të vendit, të cilat kanë synuar në evidentimin, ruajtjen, mirëmenaxhimin e përdorimin në mënyrë të qëndrueshme të tyre.


Aktualisht në Shqipëri zonat e mbrojtura përbëjnë rreth 10% të territorit. Ndonëse shpallja e tyre është bërë gradualisht ndër vite, duke filluar që në vitin 1940, deri në vitin 2002 ka munguar një ligj mbi të cilin të mbështetet kategorizimi, ruajtja e menaxhimi i këtyre zonave. Me daljen e këtij ligji në qershor të 2002 duhet thënë se ka filluar një koncept i ri që përshtatet me atë bashkëkohor dhe që në tre vitet e fundit ka gjetur zbatim në rritjen me dyfish të territorit të vendit. Rrjeti i zonave të mbrojtura mbështetet në kategoritë menaxhuese të Qendrës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës (IUCN).

Themelet e zonave të mbrojtura janë hedhur që në vitin 1940 me shpalljen/krijimin e Rezervatit të Parë Shtetëror të Gjuetisë (Kune-Vain-Tale) në Lezhë dhe në Parkun Kombëtar “Mali i Tomorrit” në Berat. Në vitin 1956, në mbështetje të Dekretit “Mbi gjuetinë dhe peshkimin në ujërat malorë” u krijua rezervati i gjuetisë në Rrushkull. Në vitin 1960, zyrtarisht krijohet Parku Kombëtar “Mali i Dajtit” dhe 6 vjet më vonë numri i tyre rritet në 6 (Thethi, Lura, Llogaraja, Dajti dhe Drenova). Parqe Kombëtare u shpallën zona me vlera të rralla e të veçanta natyrore, shkencore, shoqërore e rekreative, ku ruheshin të pa prekur ekosistemet natyrore dhe shërbenin për ruajtjen e florës dhe faunës së egër. Deri në vitin 1970 numri i rezervateve të gjuetisë arriti në 15 zona pyjore e lagunore. Me dekretin e vitit 1977 u bë riklasifikimi i rezervateve të gjuetisë dhe numri i tyre arriti në 25. Në vitin 1981 për herë të parë u vunë në mbrojtje shtetërore pasuritë natyrore të rralla, duke shpallur Monumente Natyre drurët e grumbuj pyjorë me vlerë shkencore, biologjike, historike e didaktike.

3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

Ne zonen e zhvillimit të këtij aktiviteti nuk ka burime ujore të identifikuara. Objekti ndodhet pranë Kryqezimit 4 Rrugët, Xhafzotaj, Shijak, Durres dhe nuk ndodhet në brendësi apo në afërsi të burimeve ujore të rëndësishme si Lumenjte kryesore, Liqene, Rezervuar apo Zona Bregdetare. Në afërsi të zonës ndodhet Lumi Erzen rreth 1.7km në vijë ajrore në lindje të objektit, si dhe Deti Adriatik rreth 9.5km në vijë ajrore në perëndim të objektit, i cili është edhe burimi i ujit më i madh i Rajonit.

Distancat qe ruan objekti me burimet ujore te zones



Përshkrimi i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti përfshirë edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.


Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN. Të gjashtë kategoritë e sistemit janë ekuivalente, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive. Krijimi i Zonave të Mbrojtura ka filluar që në vitin 1940. Në 1981, për herë të parë, asete të rralla natyrore u vendosën në mbrojtjen shtetërore duke shpallur si Monumente të Natyrës pyjet me vlerë shkencore, biologjike, historike dhe didaktike. Zona në vlerësim nuk vlerësohet si zone me status të veçantë nga MM. Sic shihet edhe në hartën e mëposhtme, zona në vlerësim përmban zonat e mbrojtura si mëposhte:

Prona në vlerësim, nuk ndodhet në objekt zone të mbrojtur.

Monumentet Natyrore te Rrethit Durrës.(Sipas VKM 676)

Kepi dhe Faleza e Rodonit	Shkëmbi i Kavajës
Plazhi i Kallmit	Rrapi i Rubjekës
Çinari i Balliasit	Pylli i Kolndrekajve – Ishëm
Plazhi i Shenpjetrit	

Zonat e mbrojtura në Republikën e Shqipërisë (Sipas faqes zyrtare të MM)



IMPIANT PRODHIM ASFALTOBETONI
QARKU DURRËS, BASHKIA SHIJAK, NJËSIA ADMINISTRATIVE XHAFZOTAJ, FSHATI XHAFZOTAJ, PRANË KRYQËZIMIT 4 RRUGËT

RRJETI I ZONAVE TË MBROJTURA NË SHQIPËRI

MINISTRIA E MJEDISIT				VITI 2014-MARS			
Nr.	Kategoria	Qarku	Rrethi	Emëri i ZM	Miratimi	Nr.ZM	Sipërf. Ha
1	I	Kukës	Tropojë	Lumi i Gashit	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	3,000.0
2	I	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Kardhiq	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1,800.0
KATEGORIA I Rezervat Strikt Natyror/Rezervat Shkencor - Kategoria I (RSN)					SHUMA I	2	4,800.0
3		Shkodër	Shkodër	Thethi	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	2,630.0
4	II	Dibër	Dibër	Lura	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1,280.0
5	II	Vlorë	Vlorë	Llogara	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1,010.0
6	II	Korçë	Korçë	Bredhi i Drenovës	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1,380.0
8	II	Kukës	Tropojë	Lugina e Valbonës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	8,000.0
9	II	Durrës	Krujë	Qafë Shtamë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	2,000.0
10	II	Dibër	Mat	Zall Gjoçaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	140.0
11	II	Korçë	Korçë	Prespa	VKM nr. 80, datë 18.02.1999	1	27,750.0
12	II	Vlorë	Sarandë	Butinti	VKM nr.134, datë 20.02.2013	1	9,424.4
13	II	Tiranë, Durrës		Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006	1	29,216.9
		Tiranë	Tiranë	Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006		26,772.7
		Durrës	Krujë	Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006		2,444.2
14	II	Fier, Tiranë		Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007	1	22,230.2
		Fier	Lushnjë	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		19,411.1
		Fier	Fier	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		2,074.5
		Tiranë	Kavajë	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		744.6
15	II	Elbasan, Diber		Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008	1	33,927.7
		Elbasan	Librazhd	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008		33,760.1
		Diber, Kukës	Bulqizë	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008		167.6
16	II	Gjirokastrë, Korçë		Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008	1	34,361.1
		Permet	Permet	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008		33,165.3
		Korçë	Kolonjë	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008		1,195.8
17	II	Vlorë	Vlorë	Karaburun-Sazan	VKM nr.289, datë 28.04.2010	1	12,428.0
	II	Berat, Elbasan		Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012	1	24,723.1
18	II	Berat	Berat	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		8,398.4
		Berat	Skrapar	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		15,045.8
		Elbasan	Gramsh	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		1,278.9
KATEGORIA II Park Kombetar - Kategoria II (PK)					SHUMA II	15	210,501.4
19	III	Shqipëri	Shqipëri	BioMonumente Nr.	VKM nr.676, datë 20.12.2002	348	0.0
20	III			GeoMonumente Nr.	VKM nr.676, datë 20.12.2002	398	0.0
	III			ShumaBio&Gjeo Nr.		746	0.0
21	III	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Bredhi i Sotirës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1,740.0
22		Gjirokastrë	Gjirokastrë	Zhej	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1,500.0
23	III	Vlorë	Delvinë	Syni i Kaltër	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	180.0
24	III	Dibër	Dibër	Vlashaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	50.0
				Shuma MonNatyre Nr.		4	0.0
				Totali MonNatyre Nr	VKM nr.676, datë 20.12.2002	750	0.0
KATEGORIA III Monument Natyre - Kategoria III (MN)					SHUMA III		3,470.0
25	IV	Vlorë	Vlorë	Karaburun	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	20,000.0
26	IV	Korçë	Devoll	Cangonj	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250.0
27	IV	Berat	Skrapar	Bogovë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330.0
28	IV	Korçë	Korçë	Krastafillak	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250.0
29	IV	Elbasan	Librazhd	Kuturman	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	3,600.0
30	IV	Fier	Fier	Pishë Poro	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	1,500.0
31	IV	Lezhë	Lezhë	Berzanë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	880.0
32	IV	Fier	Fier	Levan	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	200.0
33	IV	Berat	Berat	Balloll	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330.0
34	IV	Elbasan	Elbasan	Qafë Bushi	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	500.0
35	IV	Durrës	Durrës	Rrushkull	Urdhër MB nr.2, datë 28.12.1995	1	650.0
36	IV	Vlorë	Delvinë	Rrezomë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1,400.0
37	IV	Kukës	Has	Tej Drini Bardhë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	30.0
38	IV	Korçë	Kolonjë	Gëmenj-Shelegur	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	430.0
39	IV	Elbasan	Librazhd	Polis	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	45.0
40	IV	Elbasan	Librazhd	Stravaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	400.0
41	IV	Elbasan	Librazhd	Sopot	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	300.0
42	IV	Elbasan	Librazhd	Dardhë-Xhyrë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	400.0
43	IV	Shkodër	Shkodër	Ligeni i Shkodrës	VKM nr. 684, datë 02.11.2005	1	26,535.0
44	IV	Lezhë	Lezhë	Kunë-Vain-Tale	VKM nr.432, datë 28.04.2010	1	4,393.2
45	IV	Lezhë	Kurbini	Patok-Fushëkuqe-Ishem	VKM nr.995, datë 03.11.2010	1	5,000.7
46	IV	Diber, Kukës		Korab-Kontnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011	1	55,550.2
		Diber	Diber	Korab-Kontnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011		20,663.4
		Kukës	Kukës	Korab-Kontnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011		34,886.8
IV/1 Park Natyror Rajonal							
47	IV/1	Diber	Mat	Liqeni i Ulzez dhe zona perreth tij	VKQ nr. 16, datë 03.04.2013	1	4,206.0
KATEGORIA IV Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror - Kategoria IV (RNM)					SHUMA IV	23	127,180.1
48	V	Korçë	Devoll	Nikolicë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	510.0
49	V	Korçë	Pogradec	Pogradec	VKM nr. 80, datë 18.02.1999	1	27,323.0
50	V	Vlorë	Vlorë	Vjosë-Nartë	VKM nr.680, datë 22.10.2004	1	19,738.0
51	V	Shkodër	Shkodër	Lumi Buna-Velipojë	VKM nr.682, datë 02.11.2005	1	23,027.0

IMPIANT PRODHIM ASFALTOBETONI
QARKU DURRËS, BASHKIA SHIJAK, NJËSIA ADMINISTRATIVE XHAFZOTAJ, FSHATI XHAFZOTAJ, PRANË KRYQËZIMIT 4 RRUGËT

52	V	Tiranë,Diber,Elbasan		M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007	1	25,266.4
		Tirane	Tirane	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		13,213.6
		Diber	Mat	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		3,016.7
		Diber	Bulqize	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		9,036.1
KATEGORIA V		Peizazh I Mbrojtur - Kategoria V (PM)			SHUMA V	5	96,864.4
53	VI	Dibër	Dibër	Luzni-Bulaç	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	5,900.0
54	VI	Korçë	Kolonjë	Piskal-Shqeri	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	5,400.0
55	VI	Lezhë	Mirditë	Bjeshka e Oroshit	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	4,745.0
56	VI	Korçë	Pogradec	Guri i Nikës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	2,200.0
KATEGORIA VI		Zone e Mbrojtur e Burimeve të Natyrore të Menaxhuara - Kategoria VI (ZMBNM)			SHUMA VI	4	18,245.0
TOTALI ZM						16%	799

Sip. Republikës	2,874,800.00	ZM pa Sip.Detare	15.54%	446,799.7
		Sip. Detare, Ha	0.5%	13,261.2
		Karaburun-Sazan		12,428.0
		Butrint		833.2
		Sip. Bregdetare dhe Detare	%/Totalit ZM	26.95%
				119,401.5

Shkurtesat:

a	VKM	Vendim i Keshillit të Ministrave		
b	VKO	Vendim i Keshillit të Qarkut		
c	MB	Ministria e Bujqësisë		
d	ZM	Zone e Mbrojtur		

LISTA E ZONAVE RAMSAR

1	RAMSAR	Fier	Lushnje, Fier	Laguna Karavastase_Pisha Divjakes	VKM nr.413, datë 22.06.1994	Nr.Site 781, dt.29.11.1995	20,000.0
2	RAMSAR	Vlore	Sarande	Kanali Çukes-Butrint-Kepi Stillos	VKM nr.531, datë 31.10.2002	Nr.Site 1290, dt.28.3.2003	13,500.0
3	RAMSAR	Shkoder	Shkoder	Liqeni Shkodres-Lumi Bunes	VKM nr.683, datë 02.11.2005	Nr.Site 1598, dt.2.2.2006	49,562.0
4	RAMSAR	Korce	Korce,Devoll	Liqeni i Preapave	VKM nr. 489, dt. 13.06.2013	Nr.Site 2151, dt.03.07.2013	15,118.6
TOTALI						%/Totalit Republikës	3.42%
							98,180.6

DREJTORIA E BIODIVERSITETIT DHE ZONAT E MBROJTURA
 SEKTORI I ZONAVE TË MBROJTURA
 Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë.
www.mjedisi.gov.al/

Monumentet e Kultures se Rrethit Durres

NR	EMRI I MONUMENTIT	FSHATI	KOMUNA	BASHKIA	RRETHI	KATEG	INSTITUCIONI I SHPALLJES	NR.VENDIMIT	DATA E SHPALLJES
1	KALAJA NE QYTETIN E DURRESIT. Muret duke filuar nga pyrgu i rumbullakte ne hyrje te portit, duke ndjekur parkun ne perendim te qytetit deri ne kuolen 59 si dhe pjeset e mureve antik qe gjenden te shperndara ne qytet			DURRËS	DURRËS	I	Aprov. me ligjin Nr 609 dt. 24/05/ 48	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
2	KALAJA E CURRILAVE ne Muzhlin e Skenderbeut	SKENDERBEUT		DURRËS	DURRËS	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963
3	KALAJA E ISHMIT		ISHËM		DURRËS	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	Urdhëres	08.01.1977
4	MURET E PORTËS (PORTO ROMANO). 7 km ne veri te qytetit, ne mes te malit te Durresit dhe te kenetes, ne Jug te Bishitit te Palles, porta bashke me muret			DURRËS	DURRËS	I	Aprov. me ligjin Nr 609 dt. 24/05/ 48	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
5	AMFITEATRI ne qytetin e Durresit			DURRËS	DURRËS	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
6	TERMAT ANTIKE TE PALLATI I KULTURES ne qytetin e Durresit			DURRËS	DURRËS	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
7	PUSI I TOPHANES-Në Lagjen nr.1, Rr. "Aleksandër Goga" ne qytetin e Durresit			DURRËS	DURRËS	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
8	CISTERNA PRANE VARREZAVE TE DESHMOREVE ne qytetin e Durresit			DURRËS	DURRËS	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
9	GJURMET E UJESJELLESIT ANTIK PRANE SHKOLLES INDUSTRIALE DERI NE AFERSI TE FSHATIT Romanat (Frol I Gjokes), Durres	FSHATI ROMANAT	RASHBULL		DURRËS	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	2854	08.08.1980

IMPIANT PRODHIM ASFALTOBETONI

QARKU DURRËS, BASHKIA SHIJAK, NJËSIA ADMINISTRATIVE XHAFZOTAJ, FSHATI XHAFZOTAJ, PRANË KRYQËZIMIT 4 RRUGËT

10	TRAKTET E UJËSJELLËSIT ANTIK TE DURRËSIT- Nga ujesjellesi antik i Durresit i shekullit te II ruhen edhe puselat ne Arapaj e Rrushbulli dhe nje trakt ne fshatin Memaj. Perbejne gjurme te nje konstruksioni antik me vlera hidraulike qe duhen ruajtur dhe evidentuar si monument kulture				DURRËS	I	Komiteti Kulturës dhe Arteve	8	18.12.1987	
11	TRAKT I KANALIT NENTOKËSOR ME TULLA, NE RRUGEN "NAIL KONDI" DURRËS.- Pjesë e sistemit te kanalizimeve antike nentokesore te Durresit te lashte, i cili ruhet mjaft mire ne kete qytet. Datohet nga shek. V-VI eres sone.				DURRËS	DURRËS	I	Komiteti Kulturës dhe Arteve	8	18.12.1987
12	NDËRTIM ME TULLA (TABLINIUM) NE RRUGEN "VASIL KUQI", DURRËS - Objekt per ceremoni mortore brenda siperfaqes se Neokropolit te shekujve I-IV eres sone ne qytetin e Durresit.				DURRËS	DURRËS	I	Komiteti Kulturës dhe Arteve	8	18.12.1987
13	SISTEMI I KANALIZIMEVE ANTIKE TE DURRËSIT ME TRAKTET E TIJ				DURRËS	DURRËS	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	Shkresë	18.01.1986
14	KISHA E SHEN NDOJIT (Mbeturinat), afër kalasë së Curriave, Muzhli i Skenderbeut	MUZHILIN I SKENDERBEUT - KEPI I RODONIT			DURRËS	DURRËS	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963
15	BAZILIKA PALEOKRISTIANE	GJURICAJ	ISHEM		DURRËS	I	M.T.K.R.S.(drejt.Trashegimisë Kulturore	194	21.04.2006	
16	XHAMIA E FATIHUT ne qytetin e Durresit				DURRËS	DURRËS	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
17	HAMAMI NE OBORRIN E SHKOLLES 16 SHTATORI ne qytetin e Durresit				DURRËS	DURRËS	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
18	MOZAIKU PRANE PALLATIT TE KULTURES ne qytetin e Durresit				DURRËS	DURRËS	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
19	MOZAIKU TEK PALLATI I SPORTIT ne qytetin e Durresit				DURRËS	DURRËS	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
20	BAZILIKA PALEOKRISTIANE ne fshatin Arapaj, Durres. Ky monument eshte nderuar ne shek V-VI dhe ka rindertime deri ne shek. XV. Ruan vlera te rendesishme arkitektonike dhe artistike	ARAPAJ	RRASHBULL		DURRËS	I	Komiteti Kulturës dhe Arteve	8	18.12.1987	
21	ROTONDA NE QYTETIN E DURRËSIT				DURRËS	DURRËS	I	M.K.R.S.(Drejt Trasheg.Kulturore)	411	18.09.2003
22	KULLA E SULEJMAN KULLES ne fshatin Kulle	KULLE	(ISHEM)	SUKTH	DURRËS	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	Urdhëres	08.01.1977	
23	BANESA KU LINDI DHE KALOI DISA VITE TE FEMIJERISE ALEKSANDER MOISIU				DURRËS	DURRËS	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
24	BANESA KU KA JETUAR F.S.NOLI				DURRËS	DURRËS	I	Komiteti i Kulturës dhe Arteve Drejtoria e Muzeumeve dhe Arteve	4	7.05.1991
25	BANESA E FAMILJES MANUSHI DHE PALI (Banesa Nr.115)	Lagje Nr.3			DURRËS	DURRËS	I	Komiteti i Kulturës dhe Arteve Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	8 308	18.12.1987 24.05.2006
26	QARKORI I PARTISE NE ARAPAJ TE RRETHIT TE DURRËSIT. Kjo ndertese grupohet ne monumentet qe lidhen me historikun e formimit te Partise, duke qene monument perkujtimor per rrethin e Durresit si vendi ku u formua Qarkori i Partise	ARAPAJ	RRASHBULL		DURRËS	I	Komiteti i Kulturës dhe Arteve	8	18.12.1987	
27	MOZAIKU I ORFEUT-Lagja 9, Rr.Ibrahim Buzhiqi				DURRËS	DURRËS	I	M.T.K.R.S. (Ministri)	22	18.01.2010
28	RREGULLORJA PËR "ADMINISTRIMIN E ZONËS ARKEOLOGJIKE "A" DHE "B" TË QYTETIT TE DURRËSIT				DURRËS			KËSHILLI I MINISTRAVE	237	23.03.2011

Burimi i informacionit: Ministria e Kultures, (Faqa Zyrtare).

Cilesia e lumenjeve

(Bazuar ne studimin Kombetar vjetor te Agjencise Kombetare te Mjedisit)

Monitorimi i cilësisë së ujit është i rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e ujërave, identifikimin e shkaktarëve të ndotjes deri në dhënie e rekomandimeve përkatëse sipas problematikave të identifikuara. Ky program monitorimi me një frekuencë 4 here/ vit siguron një bazë të dhënash të cilat përdoren në hartimin e Raporteve të Gjëndjes së Mjedisit, në hartimin e informacioneve në nivel lokal, kombëtar e ndërkombëtar, si dhe raportimet në Agjencinë Europiane të Mjedisit.

Gjëndja e treguesve mjedisor, ndikimi në mjedis dhe tendenca


Rrjeti i monitorimit është i shtrirë në lumenj, liqene, zona bregdetare dhe stacione pranë impianteve të trajtimit të ujerave të zeza. Të dhënat e monitorimit janë të pjesshme pasi nuk u akordua buxheti i planifikuar për të realizuar programin e monitorimit. Bazuar në Urdhërin e Brendshëm me datë 13.06.2017 me Nr.prot 1464 mbi riorganizimin e procesit të monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore, cilësinë e ajrit urban dhe monitorimin e zhurmave, i cili u pezullua më datë 22.05.2017 për shkak të mungesës së financimit për të realizuar monitorimet e programuara, dhe pas kësaj date u realizuan stacionet me distancë deri në 100km. Vlerësimi paraprak i cilësisë së lumenjve dhe liqeneve përcaktohet në bazë të parametrave fiziko-kimikë duke i krahasuar me normat e lejuara të përcaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit të BE. Për klasifikimin e zonave bregdetare dhe stacionet pranë impianteve të trajtimit të ujerave të zeza i referohemi VKM 177 dt. 31.03.2005 - Normat e lejuara të shkarkimeve urbane nga impiantet e trajtimit.

Parametrat e analizuar në laborator

◆ Nevoja Biokimike për oksigjen mg/l

Nevoja Biokimike për oksigjen është sasia e oksigjenit të tretur që nevojitet të konsumohet nga organizmat biologjike aerobike të cilat ndodhen në sasinë e kampionit në shishen e pajisur me oxitop. Inkubimi në 20°C realizohet për 5 ditë ku vlera e matur shprehet në mg O/litër. Ky parametër është i rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së ujërave të lumenjve, tregues i shkallës së ndotjes. Të dhënat e marra për ekspeditat e realizuara janë paraqitur në formë grafike nga ku stacionet të cilat tejkalojnë vleren e lejuar për këtë parametër janë DLe - Drini Lezhë, T2 – Kthesa e Kamzës, L1 – Lanabregas, L2 - Yrshek dhe të tre stacionet e montorimit në Lumin Ishëm si dhe stacioni në Lumin Gjanicë Gj4. Vlerat e larta të këtij parametric dëshmojnë qartë ndikimin e shkarkimeve urbane dhe industriale të cilat derdhen në det të patrajtuara.


PËRMBAJTJA E NEVOJËS BIOKIMIKE PËR OKSIGJEN



◆ Nevoja kimike per oksigjen

Nevoja kimike për oksigjen është tregues i ndotjes kimike dhe organike, ku te dhenat e monitorimit jane paraqitur ne grafikun si vijon.


PËRMBAJTJA E NEVOJËS KIMIKE PËR OKSIGJEN



Në stacionet D1 dhe D3 nuk është vlerësuar ky parametër pasi nuk është kryer për mungesë të Kiteve.


◆ Përmbajtja e amoniakut

Përcaktimi i përmbajtjes së amoniakut në kampione uji i përcaktuar me metoden spektrometrike është parametër kryesor i klasifikimit në klasa të cilësisë së ujërave sipas DKU. Në stacionet e monitoruara të ekspeditës së kryer vërejmë tejkalim të vlerës së lejuar të vlerës limite për përmbajtjen e amoniakut në stacionin L2 – Lanabregas me vlerë 25.75 mg/l duke e klasifikuar këtë stacion në klasën V – gjendje e keqe (> 1.5 mg/l), edhe në të tre stacionet e Ishmit kemi tejkalim të vlerës. Stacioni Gj4 – Lumi i Gjanicës paraqet tejkalim të vlerës me një vlerë 2.43 mg/l duke e klasifikuar këtë stacion në Klasën V – Gjendje e keqe (> 1.5 mg/l).




◆ Përmbajtja e nitriteve

Sic vihet re edhe në grafikun e mëposhtëm, përmbajtja e nitriteve është nën normën e lejuar. Paraqitja në formë grafiku na jep qartë se vlerat e monitorimit të nitriteve janë të larta por brenda normës limite të lejuar për stacionet T2 – Ura Kthesa e Kamzës dhe Gj4 – Gjanica.




◆ Përmbajtja e nitrateve

Përmbajtja e nitrateve në të gjitha stacionet e monitoruara rezulton në vlera më të ulëta se norma e lejuar.




◆ **Përmbajtja e fosforit**

Referuar vlerave të monitorimit të ekspeditës së realizuar, vihet re se tejkalim të vlerave të lejuara për përmbajtjen e orto – fosfateve kemi në stacionin Drini Lezhë me një vlerë prej 0.306 mg/l duke e klasifikuar këtë stacion në Klasën IV – gjendje e varfër, stacioni L2 – Yrshek Ish Dogana ka një përmbajtje 2.79 mg/l Klasa V – Gjendje e keqe (norma > 0.5) stacioni me vlerën më të lartë. Gjithashtu, edhe te tre stacionet e monitorimit të lumit Ishëm janë mbi normën e lejuar dhe në Lumin Gjanicë - Gj4 paraqesin tejkalim të Klasës III – Gjendje e moderuar.



◆ **Përmbajtja e fosforit total**

Përmbajtja e fosforit total për ekspeditën e kryer gjatë vitit 2017 paraqitet në grafikun e mëposhtëm ku stacioni Drini i Lezhës është në vlerën kufi të lejuar të Klasës III – gjendje e moderuar, vlerën më të lartë të përmbajtjes së fosforit total është në stacionin L2 – Yrshek Ish Dogana si dhe tre stacionet e Lumit Ishëm janë mbi vlerën e lejuar limite. Edhe në stacionin Gj4 – Lumi i Gjanicës kemi tejkalim të vlerës limite < 0.4, përmbajtja e fosforit total në këtë stacion është 0.41 mg/l (> 0.4 < 1) gjendje e moderuar – gjendje e varfër.



Cilësia e ujërave nëntokësore

Ujerat sipërfaqësorë dhe ata nëntokësorë janë në parim burime natyrore të rinovueshme. Në veçanti, detyra e sigurimit të gjendjes së mirë të ujërave nëntokësorë kërkon veprime të përhershme dhe planifikim të qëndrueshëm afatgjatë të masave mbrojtëse, falë intervalit kohor natyral në formimin dhe rinovimin e tyre.

Të kryejë monitorimin e ujërave nëntokësore në basenet e Drinit, Matit, Erzen - Ishmit, Shkumbinit, Semanit, Vjosës e Zonës Jonike. Monitorimi synon ruajtjen e tregueseve sasiorë e cilësorë të ujit, të rezervave të shfrytëzimit, mbrojtjen e vendburimeve ekzistuese të ujit, si dhe vlerësimin e shkaqeve të ndotjes së ujërave nëntokësore. Në përfundim të monitorimit jepen rekomandimet për gjendjen aktuale të cilësisë së ujërave, trendet e përmirësimit ose përkeqësimit të cilësisë si masat për mbrojtjen e tyre si zbatimin e zonave të rreptësisë dhe të mbrojtjes sanitare, shkallën e shfrytëzimit etj.

Monitorimi i ujërave nëntokësore gjatë vitit 2017 është kryer në 7 basenet ujëmbajtëse për akuiferet porozë të kuaternarit: Shkodër, Lezhë, Fushë - Kuqe, Tiranë, Fushë - Krujë, Elbasan,

Lushnjë, Berat, Korçë, Gjirokastrë, Kafaraj, Novoselë, Vurg - Mursi e Orikum. Gjithashtu u monitoruan 11 burime kryesore të akuiferit karbonatik në basenin e Drinit - burimi Syri i Sheganit, burimi Gurra e Kolesjanit, burimi Tushemisht, burimi i Linit, në basenin e Matit - burimi i Bargjanës, në basenin e Semanit - burimi i Maçurishtit, burimi i Urës Vajguore dhe burimi i Bogovës, në basenin e Zonës Jonike - burimi Syri i Kaltër, burimi Uji i Ftohtë Tepelenë dhe burimi Uji i Ftohtë Vlorë. Ky monitorim është kryer sipas Kontratës Porosisë së lidhur ndërmjet Agjensisë

Kombëtare të Mjedisit dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për vitin 2017.

Monitorimi i ujrave nëntokësore u krye në dy faza monitorimi në basenet ujëmbajtëse të Shqipërisë në rrjetin monitorues sipas Kontratës vitit 2017 me analiza të plota kimike dhe analiza për mikroelementë.

VLERËSIMI UN TE BANESAVE 2017

BASEMET	NR. PUSIT	VENDNDODHJA	PH	NA	CA	MG	FE	NH4	CL	SO4	NO3	NO2	MP	WTN	FP	VLERËSIMI I UJIT		
BASEMI I DRINIT	1	St. Shkodrës - Dobroc	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike	
	H	St. Hot i Ril	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike	
	36	St. Vellojë - U. Gjonull	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike	
	3	Kisha e madhe-Shkoder	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike	
	Burim	Burimi Syri Sheqanit	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike	
	Burim	Burimi Linjt	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike	
	Burim	Burimi Tushemisht	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike	
Burim	Gurra e Kolesjanit	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike		
BASEMI I MATIT	50	St. Lezhë - Bardsionjt	VBN	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	Tregues jo të mirë kimike - Përmbajtje mbi normë të Na, Cl, NO ₂ vërehet në ndotje me nitrate.	
	20	St. Shëngjinit - I. Lezhë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike	
	25	RRIK	VBN	VSLMN	VBN	VLMN	VBN	VBN	VSLMN	VSLMN	VBN	VBN	VBN	VSLMN	VSLMN	VSLMN	Tregues jo të mirë kimike - Përmbajtje mbi normë të Na, Mg, Cl, SO ₄ Fp, Mp, AlH ₃ , - shitesat e poshtme ujembajtëse, ujë jo i pijshëm.	
	46	Hoteli i Gjuetisë	VBN	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Tregues jo të mirë kimike - Përmbajtje mbi norme të Na, Cl, NH ₄	
	107	St. Gurëz - Laç	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike	
	176	Milot - Laç	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike	
	177	Patok - Laç	VBN	VSLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VSLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	VBN	Tregues jo të mirë kimike - Përmbajtje të larta të Na, Cl - shitesat e poshtme ujembajtëse	
	500	St. Laçit	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike	
	26	St. Durrësit - Ruzhë - Kuç	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	Burim	Burimi i Bargjanës	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti të mira fiziko - kimike, Përmbajtje mbi normë të Fe dhe NH ₄ .
BASEMI I SHKUMBINIT	290.	St. Elbasan - Krestë e Madhe	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike	
	370.	St. Elbasan - Krestë e Vogël	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike	
	10/A	St. Motallurgjiku - Vidhas	VBN	VBN	VBTR	VLMN	VBN	VLMN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	Veti jo të mirë fiziko - kimike, ka përmbajtje mbi norme Mg, Fp, NH ₄ me tendencë më të per SO ₄ , Ca.	
	3	St. Konjat - Lushnjë	VBN	VBN	VBN	VSLMN	VBTR	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	Veti jo të mirë fiziko - kimike, ka përmbajtje mbi norme Mg, ndotje NH ₄ , me tendencë më të Fp e Fe.	
	266	St. Çermë - Lushnjë	VBN	VBN	VBN	VSLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	Veti jo të mirë fiziko-kimike, ka përmbajtje mbi norme Mg, Fp.	
	10	St. Divjaki - Çermë	VBN	VBN	VBN	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti jo të mirë fiziko-kimike, ka përmbajtje mbi norme Mg	

VBN = Vlera brenda normave
VBTR = Vlera brenda normave me tendencë më të
VLMN = Vlera të larta mbi norma
VSLMN = Vlera shumë të larta mbi norma

IMPIANT PRODHIM ASFALTOBETONI
QARKU DURRËS, BASHKIA SHIJAK, NJËSIA ADMINISTRATIVE XHAFZOTAJ, FSHATI XHAFZOTAJ, PRANË KRYQËZIMIT 4 RRUGËT

BASËMET	NR. POST	VENDNDODHJA	PN	NA	CA	MG	FE	NH	CL	SO4	NO3	NO2	MP	MTN	FP	VLERËSIM I UJIT	
BASËMI I ERZËN - ISHMIT	13	St. Kombinat-Tiranë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Voti të mira fiziko - kimike. tendence rritje e Fp
	1P	St. Selitë-Tiranë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	Voti të mira fiziko - kimike. tendence rritje e NH4, NO3.
	16/07	Rr. Kavajës - Tiranë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Voti të mira fiziko - kimike. tendence rritje e NH4, NO3.
	6	St. Laknas - Tiranë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Voti të mira fiziko-kimike-Tendencë rritje të Ca, Mg, NO3, Fp
	47	St. Bërkuil - Tiranë	VBN	VBN	VBTR	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	Voti të mira fiziko-kimike- ka fortësi të larta, përmbajtje mbi norme, tendence rritje të Ca, Mg, Mp.
	207.	Rinas - Fushë - Krujë	VBN	VBN	VBTR	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	Voti shumë të mira fiziko-kimike. Tendence rritje të Ca, Fp.
	160	St.Thumanë - Fushë-Krujë	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	Voti shumë të mira fiziko-kimike. Tendence rritje të Ca, Fp.
	1 N	St.Gramëz- Gramëz	VBN	VBN	VBTR	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	Tregues jo të mira kimike- ka fortësi të larta, përmbajtje mbi norme të Mg, ndotje mbi NO2,
	327	St.F.Krujë-F.Krujë	VBN	VBN	VBTR	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VLMN	Tregues jo të mira kimike- ka fortësi të larta, përmbajtje mbi norme të Ca, Mg
	BASËMI I SEMANIT	3	St. Korçë -Turan	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN
108		St.Bulgarec	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Voti shumë të mira fiziko-kimike, me tendence rritje Mg.
173/1		St.Shaqaras	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VSLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Voti shumë të mira fiziko-kimike, Ndotje mbi lartë NH4.
1v.		I.Terova	VBN	VBN	VBN	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Voti të mira fiziko-kimike- ka përmbajtje mbi norme të Mg, me tendencë rritje të nitratëve - pordoret për vaditje
Burim		Burimi Mançurisht	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Voti shumë të mira fiziko-kimike.
83		Banaj	VBN	VBN	VBN	VLMN	VLMN	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	Tregues jo të mirë kimike - përmbajtje mbi normë të Fe, Mg, NH4, me tendence rritje të fortësisë.
St.		Amoz	VBN	VBN	VBN	VSLMN	VBTR	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	Tregues jo të mirë kimike - përmbajtje mbi normë të Fe, Mg, NH4, me fortësi mbi normë.
St.		Çiflig	VBN	VBN	VBN	VBTR	VLMN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	Tregues jo të mirë kimike - përmbajtje mbi normë të Fe, me tendence rritje të fortësisë, Mg, NH4, NO2.
St.		Kozare	VBN	VBN	VBN	VSLMN	VBN	VBTR	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	Tregues jo të mirë kimike - përmbajtje mbi normë të Mg, Fp me tendencë rritje NH4, SO4.
		Otlak	VBN	VBN	VBTR	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	Tregues jo të mirë kimike - përmbajtje mbi normë të Mg, Fp me tendencë rritje Ca, NO3.
	Lapardha 2	VBN	VBN	VBTR	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBTR	VBN	VBN	VLMN	Tregues jo të mirë kimike - përmbajtje mbi normë të Mg, Fp me tendencë rritje Ca, NO3.	
Burim	Bogovë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Voti shumë të mira fiziko - kimike
Burim	Ura Vajgurore	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Voti shumë të mira fiziko - kimike

VBN = Vlera brenda normave
 VBTR = Vlera brenda normave me tendence rritje
 VLMN = Vlera të larta mbi norma
 VSLMN = Vlera shumë të larta mbi norma

BASENET	NR. POSIT	VENDNDODHJA	PN	NA	CA	MG	FE	NH4	CL	SO4	NO3	NO2	MP	MTR	FP	VLERËSIMI I UJIT		
BAGEMI I VJOSËS	P.V	St.Gjrokshtër Buduk	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Voti shumë të mira fiziko - kimike	
	SLB	Budkshhtë - Gjrokshtër	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Voti shumë të mira fiziko - kimike	
	Shp.	Vanistër	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Voti shumë të mira fiziko - kimike	
	St.N	St.Novosellë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Voti shumë të mira fiziko - kimike, me tendencë mtje Mg.	
	St.K	St.Kataraj	VBN	VBTR	VBN	VSLMN	VBN	VBN	VBN	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBTR	Tregues jo të mira kimike - ka Mg, Cl mbi normë, me të donohë mtje Na dhe Mo.Fp.	
	St.	Pish-Poro	VBN	VSLMN	VBN	VSLMN	VBN	VSLMN	VSLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	VLMN	VLMN	Tregues jo të mira kimike - Na, Mg, Cl, NH4 mbi normë, të larta, Mth, Mp, Na, Ujë i papijshëm.	
BAGEMI I ZONËS - JONIKE	Vlon	St.Vlon-Sarandë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Voti shumë të mira fiziko - kimike	
	Karahash	St.Karahash-Sarandë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Voti shumë të mira fiziko - kimike	
	Mursi	St.Mursi-Sarandë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Voti shumë të mira fiziko - kimike, me tendencë mtje Cl.	
	Orikum	St.Orikum-Vlorë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Voti shumë të mira fiziko - kimike	
	Burim	Syri i Kaltër	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Voti shumë të mira fiziko - kimike
	Burim	Uji i Ftohtë - Vlorë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Voti shumë të mira fiziko - kimike
STASH 3004-88(P.M.L.)			6,5-0,5	20-100	75-200	20-50	0,2 - 0,3	ni-0,05	25-200	25-250	25-250	ni-0,05	1200	500-1000	10-25(30)			
E.C. 90/778 (P.M.L.)			6,5-0,5	20-150	100	30-50	0,05-0,2	0,05-0,5	25	25-250	25-250	ni-0,1		1500,0	1-60			

VBN = Vlera brenda normave
 VBTR = Vlera brenda normave me tendencë mtje
 VLMN = Vlera jo larta mbi norma
 VSLMN = Vlera shumë të larta mbi norma

Burimi i informacionit: Raporti i gjendjes se mjedisit per vitin 2017, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombetare e mjedisit(Faqja Zyrtare).

4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.

Lloji i ndikimeve të identifikuar (direkte dhe jo direkte)

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi “Ndotësi paguan”
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" dhe ne perputhje me kerkesat e VKM Nr. 686, date 29.07.2015 "Per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis" dhe ka si synim idnetifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.:

Ndikime te rendesishme gjate funksionimit te aktivitetit.

Shkarkimet ne uje

Ujerrat qe dalin nga aktiviteti jane ujera higjenosanitare te cilat shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te zones. Nga procesi i prodhimit te asfaltobetonit, nuk ka shkarkime te lengeta, pasi procesi teknologjik nuk perfshin ujin ne teresine e tij. Shkarkimet e vetme dhe shume te rendesishme jane vetem ato te gazta ne atmosfere.

Emetimet ne ajer

Emetimet ne ajer jane pika me e rendesishme e ndotjes dhe shkarkimeve ne mjedis te ketij aktiviteti. Ndotja me e madhe vjen nga aktiviteti i prodhimit te asfaltobetonit, i cili ka ne proces furre me lende djegese hidrokarbure (solar dhe gas). Per prodhimin e asfaltit, nevojitet qe bitumi te kete nje temperature qe varion 60-90°C, ne menyre qe te shnderrohet ne trajte te lengshme dhe te behet i mundur transportimi i tij per ne mikser dhe ne furren e shkrirjes, ku arrin temperatura rreth 170-180°C. Per te arritur kete temperature, sistemi ka nje kaldaje e cila ne rastin ne vleresim, funksionon me lende djegese gas. Ndersa furra e tharjes se materialit dhe e miksimit te inerteve me bitumin funksionon me lende djegese Solar, duke qene se kerkon nje energji dhe nje temperature me te larte ne furre. Gjithashtu vlen per tu theksuar edhe gjeneratori i cili eshte ne permasa dhe kapacitet relativisht te madh, por ai ndizet shume rralle, vetem kur ka shkeputje te energjise elektrike nga rrjeti dhe kur kjo shkeputje perkone me procesin e prodhimit te asfaltobetonit, i cili bllokone dhe demton makinerite ne rast te nderprerjes se punes. Duke qene se perdoren lendet djegese ne procesin e prodhimit te energjise (ne kJ apo kW), keto te fundit shoqerohen me clirime ne ajer te gazeve ndotes per mjedisin, te tilla si: CO, CO₂, NO_x, SO_x.

Keto gaze bejne pjese tek grupi i gazeve "Greenhouse Gases", te cilat kontribuojne ne efektin "serre" dhe si rrjedhoje edhe ne ndryshimet klimatike. Eshte e rendesishme te theksojme se keto gaze, clirohen ne sasira teper te medha nga trafiku urban kryesisht me djegie te brendshme ne qytetet e medha dhe ne zona me trafik te renduar, sic jane Tirana,

Elbasani, Durresi, Fieri, etj. Keto gaze jane ne perberje te lendeve djegese, por raporti dhe sasia e tyre e cilruar per kJ, eshte e ndryshme. Gazet kryesore te ngrohjes globale: Dioksidi i Karbonit (CO₂) = 82%. Metani (CH₄) = 10%, Oksidi Nitratit (N₂O) = 5%, Hidrofluorokarbonet (HFCs), Perfluorokarbonet (PFCs), HekzafluoridSulfuri (SF₆), dhe Triflourid Azoti (NF₃) = 3%.


Karburantet e ndryshme lëshojnë sasi të ndryshme të dioksidit të karbonit (CO₂) në lidhje me energjinë që prodhojnë kur digjen. Për të analizuar emetimet nëpër karburante te ndryshme, mund te krahasojme sasinë e CO₂ te emetuar, për njësi të prodhimit të energjisë apo për ngrohje.

Keshtu, ne nje vleresim teorik (nga nje studim ne Britanine e Madhe "<http://www.eia.gov>"), sasia e CO₂, e cilruar ne atmosfere per nje sasi energjie prej 1,000,000 Btu(British Thermal Units) ose e konvertuar 1,055,056 KJ (kilo Joule) te prodhuar nga lenda djegese nafte e perpunuar eshte rreth 161.3 Pound (1 Pound= 453.59 gram).


Sasia e prodhuar/emetuar e CO₂ gjate procesit te djegies se nje karburanti eshte ne varesi te permbajtjes se kesaj te fundit ne lenden djegese. Energjia ne ngrohje, apo sasia e energjisë së prodhuar nga djegia e nje karburanti, përcaktohet kryesisht nga permbajtja ne karburant e karbonit (C) dhe hidrogjenit (H). Nxehtesia prodhohet kur C dhe H kombinohen me oksigjenin (O) gjatë djegies. Gazi natyror është kryesisht metan (CH₄), i cili ka një sasi më të lartë përmbajtje të energjisë në krahasim me karburantet e tjera.

Hidrokarburet aktualisht janë burimi kryesor i fushës së energjisë dhe ngrohjes (si për shembull në shtëpi për ngrohje, mund te perdorim kaldaja me Nafte ose me Gaz). Shpesh kjo energji përdoret drejtpërdrejt në teknologjine e automobilave, te mjeteve te ndryshme te transportit, si anije, trena, etj. Gjithashtu nje perdorim jo pak i perhapur eshte edhe perdorimi ne sistemet ngrohese, të cilat i përdorin si lëndë djegëse ose naftën ose gazin natyror. Djegia e hidrokarbureve përdoret për të ngrohur ujë, i cili pastaj qarkullon ne ambjent per te cilruar nxehtesi Në parim, i ngjashëm me përdorimin për të prodhuar energji elektrike në termocentralet. Metani liron vetëm një dioksid karboni (CO₂) për dy Molekulat e ujit (H₂O).

Vetitë karakteristike të hidrokarbureve janë që ata prodhojnë avull, dioksid karboni dhe nxehtësi gjatë djegies dhe se duhet patjetër prania e oksigjenit që djegia të ndodhë. Hidrokarburi më i thjeshtë, metani, digjet në këtë formë:



Një tjetër shembull është propani:



Djegia e hidrokarbureve është një shembull i një reaksioni kimik ekzotermik.

Disavantazhet e lendeve djegese Solar/Mazut

1. Viskoizitet i larte, cka do te thote se nevojitet ngrohja e tyre ne temperaturat 65-90°C, per transportimin e tyre.
2. Permbajtje te larte te Squfurit, emetime te larta te dioksidit te sulfurit SO₂
3. permbajtje e larte e ndotesve te ngurte, kerkojne patjetër perdorimin e filtrave.

Instalimi eshte i pajisur me filtra me thase, te cilet kryejne kapjen e pluhurit dhe e depozitojne ate ne canta te medha nga ku rifutet perseri ne ciklin e prodhimit te asfaltobetonit dhe humbet me lenden e ngurtesuar te asfaltit.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat që prodhohen në kantier janë të ndryshme. Ato mund të shkaktohen nga mjetet e transportit të rënde, nga mjetet e ngarkim-shkarkimit të materialit dhe procesit të impiantit të prodhimit të asfaltobetonit. Gjithashtu zhurma mund të shkaktohen edhe nga përdorimi i kompresoreve dhe i gjeneratorit në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike. Këto zhurma nuk janë të larta për punonjësit, megjithatë, në rast të shqetësimeve të mundshme, ata mund të përdorin kufje gjate punës. Për objektet përreth zonës nuk është një problem pasi ato ndodhen në një distancë të tillë që nuk ndikohen nga zhurmat e aktivitetit.

Ndikimi në toke

Ky aktivitet nuk ndikon në mënyrë të drejtperdrejtë në toke. Nuk ka shkarkime në toke. Në mënyrë indirekte, shkarkimet në ajër, mund të shndërrohen në element ndotes për token, por kjo në sasi tepër të moderuar.

Ndikimi në Biodiversitet

Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e ndjeshme të zonave të mbrojtura me ligj, gjithashtu ky lloj i aktivitetit nuk ndikon në biodiversitet. Aktiviteti ndodhet në një zonë pa bimesi.

Ndikimi në Mjedisin Social

Ndikimi i këtij aktiviteti në mjedisin social, është pozitiv përse i perkete punesimit, sherbimit të mirembajtjes dhe rikonstruksionit të rrugeve, etj. Për të shmangur katastrofat e rënies së zjarrit, megjithatë ato nuk ndodhin shpesh por edhe duke qene të rralla ato perbejne potencial demtimi ekonomik, social, e mjedisor. Objekti nuk duhet të funksionojë në një zonë të rrezikuar nga përmbajtjet, të rrezikuar nga zjarret (sic janë pyjet pa akses rrugor), në kantier nuk duhet të ketë akses askush i paautorizuar dhe duhet të ketë siguri të ruajtjes fizike maksimale. Është shumë e rëndësishme të respektohen rregullat e sigurimit teknik në punë. Ndikimi në shëndetin e punonjësve apo të banorëve të zonës, është në varesi të nivelit të shkarkimeve në ajër. Duke qene një instalim i ri, brenda të gjitha standarteve dhe me sistem filtrimi të shkarkimeve në ajër, vleresohet të mos shoqerohet me ndikime në shëndetin e popullatës. Përveç të tjerash, nisur edhe nga kapaciteti prodhues i instalimit, do të funksionojë pak orë në ditë dhe do të ketë ditë gjate të cilave nuk do të funksionojë fare. Kështu, shkarkimet në mjedisin e zonës, bazuar në standartin e fabrikës, gjenden në mjedisin të zonës, si dhe orëve të punës, shkarkimet në ajër nuk vleresohen me ndikime të rëndësishme. Subjekti, brenda gjashtë muajsh nga data e leshimit të lejes mjedisore, do të kryej matjen e shkarkimeve në ajër nga laborator të akredituar dhe rezultatet do të verë në dispozicion të institucioneve perkatese dhe publikut të gjere të interesuar.

Mbetjet e prodhuara

Mbetje të ngurta që prodhohen janë ato urbane nga aktiviteti human. Nuk vleresohet aktivitet me mbetje të ngurta, paletat, plastmasi, metalet, etj, janë 100% të riciklueshme dhe menaxhohen nga kompania që mbulon këto shërbime në zonë. Mbetje të rëndësishme në këto procese teknologjike, është vetëm pluhuri i kapur nga filtri, i cili rifutet në ciklin e prodhimit të asfaltobetonit dhe humbet me lëndën e ngurtësuar të asfaltit.

5. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.

Informacion për shkarkimet në mjedis.

Emetimet ne ajer jane pika me e rendesishme e ndotjes dhe shkarkimeve ne mjedis te ketij aktiviteti. Ndotja me e madhe vjen nga aktiviteti i prodhimit te asfaltobetonit, i cili ka ne proces furre me lende djegese hidrokarbure (solar dhe gas). Per prodhimin e asfaltit, nevojitet qe bitumi te kete nje temperature qe varion 60-90oC, ne menyre qe te shnderrohet ne trajte te lengshme dhe te behet i mundur transportimi i tij per ne mikser dhe ne furren e shkrirjes, ku arrin temperatura rreth 170-180oC. Per te arritur kete temperature, sistemi ka nje kaldaje e cila ne rastin ne vleresim, funksionon me lende djegese gas. Ndersa furra e tharjes se materialit dhe e miksimit te inerteve me bitumin funksionon me lende djegese Solar, duke qene se kerkon nje energji dhe nje temperature me te larte ne furre. Gjithashtu vlen per tu theksuar edhe gjeneratori i cili eshte ne permasa dhe kapacitet relativisht te madh, por ai ndizet shume rralle, vetem kur ka shkeputje te energjise elektrike nga rrjeti dhe kur kjo shkeputje perkon me procesin e prodhimit te asfaltobetonit, i cili bllokton dhe demton makinerite ne rast te nderprerjes se punes. Duke qene se perdoren lendet djegese ne procesin e prodhimit te energjise (ne kJ apo kW), keto te fundit shoqerohen me clirime ne ajer te gazeve ndotes per mjedisin, te tilla si: CO, CO2, NOx, SOx. Keto gaze bejne pjese tek grupi i gazeve "Greenhouse Gases", te cilat kontribuojne ne efektin "serre" dhe si rrjedhoje edhe ne ndryshimet klimatike. Eshte e rendesishme te theksojme se keto gaze, clirohen ne sasira teper te medha nga trafiku urban kryesisht me djegie te brendshme ne qytetet e medha dhe ne zona me trafik te renduar, sic jane Tirana, Elbasani, Durresi, Fieri, etj.

Zhurmat qe prodhohen ne kantier jane te ndryshme. Ato mund te shkaktohen nga mjetet e transportit te rende, nga mjetet e ngarkim-shkarkimit te materialit dhe procesit te impiantit te prodhimit te asfaltobetonit. Gjithashtu zhurma mund te shkaktohen edhe nga perdorimi i kompresoreve dhe i gjeneratorit ne rast te nderprerjes se energjise elektrike. Keto zhurma nuk jane te larta per punonjesit, megjithate, ne rast te shqetesimeve te mundshme, ata mund te perdorin kufje gjate punes. Per objektet perreth zones nuk eshte nje problem pasi ato ndodhen ne nje distance te tille qe nuk ndikohen nga zhurmat e aktivitetit.

Mbetje te ngurta qe prodhohen jane ato urbane nga aktiviteti human. Nuk vleresohet aktivitet me mbetje te ngurta, paletat, plastmasi, metalet, etj, jane 100% te riciklueshme dhe menaxhohen nga kompania qe mbulon kete sherbim ne zone. Mbetje e rendesishme ne kete proces teknologjik, eshte vetem pluhuri i kapur nga filtri, i cili rifutet ne ciklin e prodhimit te asfaltobetonit dhe humbet me lenden e ngurtesuar te asfaltit.

6. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.

Ndikimi i aktivitetit ne kushte normale funksionimi do te zgjase per aq kohe sa zgjat edhe aktiviteti prodhues. Ndersa persa i perkete ndikimeve gjate nje avarie, pra renies se zjarrit dhe djegia e lendeve djegese ne menyre te menjehereshme, ky ndikim mund te jete i dukshem dhe i rende per disa dite. Ndikimi i shkarkimeve te gazeve nga lenda djegese do te jete i perkohshem, vetem per aq ore sa do te funksionoje impianti i prodhimit te

asfaltobetonit. Kjo mund të zgjase disa ore në ditë, dhjetëra ore në javë, apo edhe në muaj e në vit, kjo në varësi të punës dhe projektit që do të ketë në subjektin.

7. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS

Ndikimi në mjedisin e zonës në kushte normale të punës, mund të përhapet në një distancë të ngushtë, me qindra metra, por në një distancë rreth 300-500m, por në varësi të kushteve klimatike dhe drejtimit të shpejtësisë së erës, tymi mund të përhapet edhe në një distancë pak më të madhe se kjo. Ky ndikim do të jetë i perkohshëm vetëm gjatë fazës së ndezjes së impiantit të prodhimit të asfaltobetonit. Gazet e shkarkuara nga oxhaku i djegies së solarit, do të përhapen në atmosferë dhe do të perzihen me ajrin e pastër duke humbur efektin dhe përqendrimin e lartë të tyre në atmosferë. Këtë instalim i është instaluar një sistem reduktimi të gazeve, instalimi i filtrave duke reduktuar ndjeshëm sasinë e gazeve që shkarkohen në ajër. Megjithatë, rekomandojmë që pas pajisjes me leje mjedisore, subjekti, të kryejë analizat e para të gazeve që cirohen në atmosferë dhe të krahasojë ato me normat e lejuara sipas legjislacionit në fuqi.

8. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.

Subjekti investitor, duhet të kujdeset për një mjedis të pastër, të rregullt, të gjelberuar, të sigurtë dhe të pajisur me sinjalistikën dhe posterat sensibilizues përkatës për kushtet teknike dhe për mjedisin. Mjedisin e këtij aktiviteti është me funksion si kantier i prodhimit të asfaltobetonit dhe si rrjedhojë duhen zbatuar kushtet teknike, duhet zbatuar projekti i mbrojtjes nga zjarri duhet të kryhet një menaxhim dhe rehabilitim i mjedisit rrethues. Në rast të mbylljes së aktivitetit, mund të merret në konsideratë mundësia e rehabilitimit të plote të sipërfaqeve dhe kthimin e peizazhit në gjendjen e mëparshme. Kjo me kosto të vogla, mund të kthehet në një mjedis të rregullt dhe në gjendje natyrore, pasi nuk ka demtuar sipërfaqe ose reliev të madh të zonës.

9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

Masat mbrojtëse dhe kushtet teknike që duhet të zbatohen në pikat e magazinimit me pakice të karburanteve.

Rreziku për rënien e zjarrit në objekt

Gjatë funksionimit mund të sjellë rrezikshmeri për aksidente. Në rast se do të kemi derdhje të lendeve si hidrokarbure nga automjetet e transportit duhet të merren masa për largimin e saj nga mjedisi si dhe duhet të vendosen tabela sinjalizuese për të shmangur aksidente rrugore gjatë hyrjes dhe gjatë daljes nga objekti.

Produktet e karburantit dhe temperaturat e ndezjes

Nxhetësia e mjaftueshme për të krijuar avullimin e karburanteve që mund të ndizen, quhet pika e ndezjes së Benzolit 40°C. Benzoli mund të avullojë më tej edhe në 40°C. Gazoili 55°C. Gazoili avullon në temperaturë 55°C dhe më të lartë se kjo. Në kontakt me një lëndë ndezëse, nuk është karburanti ai që merr flakë, por gazi që lëshon. 1 litër karburant krijon 300 herë vëllim më të madh nga avullimi. Kur avullon 1 litër LPG, arrin në vëllimin 248 herë më të madh.

Gjithashtu avujt e produkteve të karburantit dhe LPG-së, për shkak se janë më të rënda se ajri, nuk largohen nga stacioni por rrijnë aty dhe krijojnë mundësinë e një plasjeje apo djegieje. Avujt e karburantit dhe Gaz-it, janë më të rëndë se ajri, për këtë arsye në stacionet e magazinimit, gjithmonë gjendet avull karburanti dhe Gaz-i.

Në ambjentet e stacioneve, në zonat ku avulli i karburantit është më i dendur, përdorimi apo ndodhja e një lënde djegëse, ndez avullin e karburantit. Për këtë arsye në mjediset e magazinimit nuk duhet të gjendet, asnjë burim shkëndije apo zjarri që mund të ndezë avullin e çliruar.

Zjarri shkaktohet nga bashkimi i tre elementëve: Burim zjarri ose Nxehtësi, lënda djegëse dhe prania e Oksigjenit. Benzoli, i cili mund të ndizet ose avullojë në temperature 40°C, është një produkt shume i rrezikshëm. Avulli i benzolit: sidomos në mot të qetë dhe pa erë, grumbullohet në pjeset me te aferta me sipërfaqen e tokës. Për këtë arsye mund te jete nje rrezik per zonat qe ndodhen shkëndija ose burime nxehtesie.

Elektro-Statika

Ngarkesa elektirke që shkaktohet nga fërkimi i dy trupave, quhet Elektro-Statike.

Shëmbulli më konkret që mund të jepet për eketro–statikën është rrufeja. Në jetën e përditshme, kur hapim derën e makinës, kur krehim flokët, kur përdorim nje veshtje sintetike, etj, krijohet fenomeni i elektrizimit sintetik.

Automjetet gjatë rrugës, para se të hyjnë në pikën e ruajtjes se karburantit, gjatë rrugës duke qenë në lëvizje fërkohen me ajrin dhe për këtë arsye krijojnë një elektrizim statik. Nëse automjeteve kur hyjnë në terminal, nuk u shkarkohet elekticiteti qe zoterojne, ne lendet e ndjeshme, kjo mund te jete nje rrezik.

Zjarret e Karburanteve

Zjarret e karburanteve klasifikohen ne tre lloje. Zjarret A, B dhe C.

Zjarret e lëndëve si benzol, gazoil, vajgur, alkol, klasifikohen në zjarret B. Lëngjet djegëse, krijojnë zjarre lëndësh. Pika bazë në fikjen e këtyre zjarreve, është mbytja e flakës. Lënda më efektive në fikjen e këtyre zjarreve, është shkuma dhe pluhurat. Në zjarret e krijuara nga benzoli dhe gazoili, nuk duhet te perdoret ujë. Uji ne kete rast, luan rol negativ.

Zjarret GLN, klasifikohen në zjarret e tipit C. Jane zjarre lëndësh djegese te gazta. Gazet si, gazi natyral që përdoret në familje, hidrogjeni, GLN, dhe metani jane lendet djegese te gazta. Lëndët me eficente per shuarjen e tyre jane shkuma dhe pluhurat.

Shkaqet e renies se zjarrit ne objekt

- Cigare
- Elektro-Statika
- Celulari
- Ndrichimi dhe rrjeti elektrik i amortizuar
- Kryerja e saldimeve në ne afersi te karburaneve

Bombulat per mbrojtjen nga zjarri

Për të qënë të sigurt se në një rast urgjent, bombula e fikësit të zjarrit me pluhur që ndodhet në piken e karburantit, do të jete funksionale, duhet qe te mirëmbahet dhe testohet here pas here. Kontrolle periodike nga subjekti qe kryen rimbushjen e tyre.

Ne menyre te pergjithshme do te japim disa prej masave qe duhet te zbatohen nga investitori ose zhvilluesi i aktivitetit per mbarefunksionimin e aktivitetit dhe ruajtjen e mjedisit fizik e biologjik.


- Duhet te punohet sipas rregullores se kushteve teknike, nuk duhet te lejohen derdhje te karburanteve dhe lendeve te tjera djegese, pasi ndotin ambientin dhe mund te jene burim aksidenti e shkaktar te zjarreve te pa deshiruara.
- Ne sheshin e aktivitetit, nuk duhet te magazinohen materiale te rrezikshme si lende plasese, etj.
- Mjetet rrugore qe qarkullojne duhet te jene konform normave te percaktuara dhe te testuara nga Qendra e Kontrollit Teknik te automjeteve e te pajisura me certifikaten e Vertetimit Teknik nga Inspektoriati Qendror Teknik.
- Persa i perkete plhurave LNP tek punonjesit ne kantier qe jane te ekspozuar, rekomandohet perdorimi i maskave me filter dhe syze.
- Persa i perkete zhurmave te makinerive, rekomandojme perdorimin e kufjeve per te mbrojtur shqisat e degjimit.
- Te merren te gjitha masat e nevojshme per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, si dhe te mos lejohet shkarkimi i pa kontrolluar i lendeve djegese ne mjedisin e kantierit.
- Ambienti te mbahet paster dhe te mos kete asnje derdhje te lendeve te djegshme ne sheshin e kantierit, te shtrohet me beton/asfaltobeton sheshi i ngarkimit e shkarkimit te mjeteve ne menyre qe te shmangen derdhjet e lendeve te lengshme ne mjedisin e zones.
- Depozitat e lendeve djegese te ruhen ne kushte optimale dhe te mbuluara me tende per mbrojtjen nga rrezatimi dhe nxehtesia diellore.
- Te ndertohen rrufepritesit ne te kater qoshet e sheshit te zhvillimit te aktivitetit.
- Per te shmangur efektet e djegies dhe te shperthimit, subjekti duhet te jete pajisur me depozite uji dhe sistem teper efektiv e te disponueshem per te reduktuar demet ne raste te tilla te fenomeneve.
- Objekti nuk duhet te jete i rrezikuar nga permbytjet, erozioni, zjarri (sic jane pyjet), nuk duhet te kete akses askush i paautorizuar dhe duhet te kete siguri fizike maksimale.
- Ne objekt automjetet zjarrefikese duhet te kene akses te plote rrugor.
- Te sigurohet roje 24 ore dhe te ruhet objekti nen kushte te rrepta sigurie.
- Te mos kryhet asnje rikonstruksion apo riparim i instalimit, pa mbikqyrjen e drejtuesit teknik dhe pa boshatisjen e depozitave te lendeve djegese.
- Ne rast te shkarkimeve mbi normat e lejuara, subjekti te kryeje investime per reduktimin e gazeve qe shkarkohen ne mjedis, duke aplikuar filtra ose sistem te reduktimit te gazeve.

10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhoje edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim te mjedisit nderkufitar. Projekti nuk ndikon ne cenimin e sigurise se jetes dhe shendetit te shteteve fqinje, madje ne kushte normale, as te qendrave te banuara te rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilesia e ajrit ne kontekstin nderkufitar. Per kete kapitull, nuk kryhen vleresime dhe analiza te detajuara per shkak te vendodhjes se projektit ne brendesi te kufirit shteteror dhe distances qe ai ruan me kufirin dhe shtet fqinje.

Aneks:

Harta topografike e rajonit. Nomeklatura e Hartes ne shkalle 1:2500 (K-34-88-(242-A))



Koordinatat e objektit ne sistemin: Gaus-Krüge		
Nr.	Koordinatat Lindje X	Koordinatat Veri Y
1	4377355.08	4580961.68
2	4377341.10	4581005.75
3	4377256.24	4580982.14
4	4377268.30	4580936.93



MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES



Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

Numri serial: LN-2068-09-2016
NUIS/NIPT: L62113034E

LICENCË

Subjekti: Laert Shehu

Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Njësia Bashkiake nr.4, Rruga Khanfize Keko, Pallati Andi Konstruksion, Hyrja nr.4, Apartamenti nr.8.

Kodi: III.2.A (1+2) Kod tjetër:

Data e lëshimit: 13/09/2017 Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

- Ndikim në mjedis
- Auditim mjedisor

Specialiteti

E vlefshme për subjektin "A.L-ASTALT"
"Tregimant problemit "enfektibetimi" i ndodhur
Xhefitej, pranë kryerimit u mjet.

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Vlerësim i ndikimit në mjedis. Auditim mjedisor

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

TERMBLESHJE DOTEKNIKE

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë




SHPK

no DAMES!
Nënshkrimi i sportelit: Florbeg



Kjo çertifikatë mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji ose ndërprerje detyrimi ligjor për të qënë person i tatueshëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 11659 Prot.

Tiranë, më 12.12 2014

Nr. identifikues 262

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. LAERT SHEHU

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar dhe hartuar vlerësimin të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.



*Evlojshme për subjektin "A.L - ASFALTI S.A.
"Injant prodhimi asfaltbetoni", i ndodhur
rreth Durrës, Xhejzafaj, pranë kryqzimit
rrugës.*

MINISTRI

Lefter KOKA

TERMBLENDJE DËTEKNIKE